



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 39, datë 31.03.2020

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “INSIG JETË” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike të shoqërisë “Insig Jetë” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2019, sipas përlogaritjes të shoqërisë.**
- 2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2019 të provigjoneve teknike dhe matematike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:**

Provigjonet teknike dhe matematike në 31 dhjetor 2019	Lekë
Provigjone teknike dhe matematike të primeve e dëmeve bruto në total	180,887,813
<i>Provigjone teknike dhe matematike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>8,641,241</i>
Provigjone teknike dhe matematike të primeve e dëmeve neto në total	172,246,572

- 3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ervin METE _____ KRYETAR

Idlir GJATA _____ ANËTAR

Deniz DERALLA _____ ANËTAR